



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 24.7.2013, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj,
Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe
Duda Balje.

Munguan: Justina Pula.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi - zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri,
mbështetës i Komisionit-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Nuredin Ibishi-UNDP, Elita Vokshi-OSBE, Lejla Selimi-OSBE,
dhe Visar Bivolaku-Eu OFFICE-EUSR

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 17 korrik 2013;
3. Shqyrtimi i raportit kundër trafikimit me qenie njerëzore për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve për të drejtat e fëmijëve;
5. Shqyrtimi i realizimit të Planit të Punës për Sesionin Pranveror 2013 dhe përgatitja e Planit për Sesionin Vjeshtor 2013;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja – Propozoi që në rend të ditës të shtohet shqyrtimi i një peticioni, si dhe rishqyrtimi i rekomandimeve të dalura nga Raporti i monitorimit të Ligjit për Barazi gjinore.

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17 korrik 2013

Kryetarja- Tha se është bërë një lëshim në procesverbal pasi që nuk kam thënë e kam kontaktuar kryetarin e Komisionit qeveritar për persona te pagjetur, por ai me ka kontaktuar mua.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e paraqitur nga kryetarja.

3. Shqyrtimi i raportit kundër trafikimit me qenie njerëzore për vitin 2012

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se kjo pikë e rendit të ditës ka qenë e paraparë të shqyrtohet në mbledhjen e kaluar. Mirëpo është shtyrë për këtë mbledhje për shkak të kërkesës së Kymete Bajraktarit, e cila ka munguar takimin e kaluar. Ajo i njoftoi anëtarët se raporti është dorëzuar në të dy gjuhët dhe pastaj ia dha fjalën anëtarëve të Komisionit.

Kymete Bajraktari – Theksoi se të dhënat janë mjaft shqetësuese pasi që në raporte ndërkombëtare, si dhe në këtë raport thuhet se Kosova është vend tranzit për trafikimin e grave dhe fëmijëve kosovarë. Ajo, po ashtu, shfaqti vërejtjet e saj lidhur me përmbajtjen e këtij raporti. Lidhur me përmbajtjen e raportit ajo theksoi se ka aq shumë përsëritje të veprimeve dhe për shkak të këtyre veprimeve raporti është më voluminoz se sa aktivitetet dhe veprimet që janë ndërmarrë. Ajo tha se Qeveria nuk i përmbahet standardeve minimale për luftimin e trafikimit. Shqetësim tjetër që ajo paraqiti ishte se të gjitha aktivitetet e Qeverisë për vitin 2012 për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore janë fokusuar në trajnime, seminare dhe fushata të vetëdijësimit. Si veprime jo të arsyeshme, që ajo e konsideroi ishin trajnimet që janë mbajtur për gjyqtarët dhe prokurorët. Ajo ishte e mendimit se gjyqtarët dhe prokurorët janë profesionalë dhe nuk kanë nevojë aq shumë për trajnime kur egziston ligji, sepse ligji shumë qartë precizon veprimet që i takojnë gjyqtarit dhe veprime që i takojnë prokurorit. Shqetësim tjetër që ajo paraqiti ishte rritja e numrit të fëmijëve të trafikuar. Ajo, po ashtu, paraqiti një shpërputhje në mes të numrit të fëmijëve të trafikuar që i përmban ky raport në krahasim me raportin që e ka paraqitur Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale në takim me Komisionin. Në atë takim ministri ka deklaruar se janë 26 fëmijë të trafikuar, kurse në

këtë raport paraqiten 12 fëmijë të trafikuar, numër i njëjtë i fëmijëve të trafikuar (12) paraqitet edhe në raportin e paraqitur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, i cili quhet Raporti i vlerësimit për fëmijë. Ajo shfaq shqetësimin e saj për ngritjen e numrit të fëmijëve të trafikuar, sepse në vitin 2010 kanë qenë 7 fëmijë të trafikuar, në vitin 2011 kanë qenë 17 fëmijë të trafikuar, kurse në vitin 2012 kanë qenë 26 fëmijë të trafikuar, domethënë ka ngritje të vazhdueshme të numrit të fëmijëve të trafikuar. Si të metë në këtë raport ajo ceku se nuk është bërë klasifikimi i viktimave të trafikuar në mënyrë që ta kemi të qartë se fëmijët e trafikuar a janë lypës, a janë të shfrytëzuar seksualisht, ose kryejnë punë të detyrueshme. Te rekomandimet dhe konkluzionet e këtij raporti ajo ishte e mendimit se disa rekomandime në këtë raport janë të tepërta, dhe shfaqi dilemat e saj se a është e nevojshme që akoma të trajnohen apo duhet të ketë një afat kohor për këto trajnime në mënyrë që të mos përsëriten çdo vit trajnimet e njëjta? Ajo tha se janë 5 rekomandime në këtë raport të cilat fokusohen në trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, policëve, mësuesve si dhe zyrtarëve të tjerë që merren me aktivitete kundër trafikimit. Ajo tha se duhet të caktohet një kohë gjatë së cilës duhet të trajnohen këto subjekte dhe nuk është e nevojshme që çdo vit të bëhen shpenzime për trajnime të njëjta. Ajo ishte e pajtimit që të vazhdohet me fushatat e vetëdijësimit për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Sa i përket trajnimeve për nivelin lokal ishte e pajtimit, sepse siç tha ajo është e nevojshme një gjë e tillë ngase Qeveria ka organizuar trajnime vetëm për nivelin qendror dhe sipas saj është lënë anash niveli lokal. Mbi të gjitha ajo theksoi se është e nevojshme që të koncentrohen shpenzimet në trajtimin e viktimave dhe përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës. Si hap pozitiv që ajo theksoi ishte që së shpejti do të vijë ligji dhe kjo mund të konsiderohet si progres. Mirëpo shqetësuese është mungesa e rezultateve. Lidhur me raportin ajo ishte e mendimit se raporti nuk është edhe aq serioz për arsye të mospërputhjes së numrave të personave të trafikuar në paraqitjet tabelare.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke u ndërlidhur theksoi se paraqitja tabelare e viktimave të trafikuar megjithatë është në rregull duke i përfshirë personat e trafikuar, si dhe ata të cilëve i'u është ofruar ndihmë.

Kymete Bajraktari – Kishte vërejtje tek emërtimi “ Fëmijë”. Ajo tha se me këtë emërtim nuk përfshihen vetëm grup-moshat 14 – 17 vjeç, por grup-moshat nga 0 deri në 18 vjeç.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur i njoftoi Komisionin se gjatë vizitës në Bruksel në Konferencën që për temë ka pasur fëmijët që bien ndesh me ligjin edhe në këtë Konferencë është paraparë që gjyqtarët duhet të kenë trajnime të veçanta në raport me fëmijët me qëllim që ta kryejnë punën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Lidhur me raportin ajo tha se sa i përket trajnimeve që janë mbajtur kanë qenë të qëlluara.

Kymete Bajraktari – Ishte e mendimit se trajnimet janë të qëlluara, mirëpo duhet ta kenë një afat të caktuar, e jo të përsëriten dhe të bëhet shpenzime të kota lidhur me trajnimet.

Kryetarja - Kishte vërejtje në raport pasi që mungojnë grup-moshat deri në 14 vjeç pastaj nuk është i detajuar sa duhet sepse sipas raportit të Avokatit të Popullit ka numër

shumë më të madh të fëmijëve të trafikuar. Andaj këtij raporti i mungon një informacion i mirfilltë lidhur me trafikimin e fëmijëve. Ajo propozoi që ky raport të plotësohet me një shkresë e cila do të sqarojë situatën e fëmijëve të grup-moshës nga 0 deri në 14 vjet, sepse mungon informacioni rreth kësaj kategorie të fëmijëve.

Albana Gashi – Ishte e mendimit se në raport nuk duhet të ndodhë klasifikimi i kategorive të qenieve të trafikuar, sepse në raport paraqiten se kategori të rrezikuara fëmijët dhe femrat. Mirëpo në realitet ka shumë raste edhe të trafikimit ku viktimat kanë qenë të gjitha grupmoshat të dy gjinive, e jo vetëm gratë dhe fëmijët. Ajo kishte vërejtje edhe te pjesa e raportit ku flet vetëm për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, ndërsa nuk flet fare për moshat dhe kategoritë e tjera. Ajo propozoi që të ofrohen informacione edhe për kategoritë e tjera, në mënyrë që të jetë një pasqyrë më reale e gjendjes.

Kymete Bajraktari – Theksoi se raporti i cili duhet të plotësohet nuk duhet të ketë aktivitetet e njejta të paraqitura në shtylla të ndryshme, siç ka ndodhur me këtë raport, por të paraqiten ato aktivitete të cilat i ka kërkuar Komisioni.

Kryetarja – Tha se duhet të jenë të paraqitura edhe të arriturat që janë bërë nga mbajtja e trajnimeve, sepse një gjë e tillë mungon në raportin aktual.

Pas një debati të gjerë Komisioni vendosi që të kërkojë plotësimin e këtij raporti me vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve për të drejtat e fëmijëve.

Kryetarja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se me inicimin e Komisionit më 1 qershor 2012 është mbajtur Seancë lidhur me të drejtat e fëmijëve me ç’ rast kanë dalë disa rekomandime të cilat i’u janë drejtuar institucioneve të Republikës së Kosovës. Pas një kohe relativisht të gjatë Komisioni ka mbajtur një Dëgjim Publik me qëllim të vertetimit se sa janë zbatuar rekomandimet e dalura nga Kuvendi. Ajo theksoi se lidhur me këtë takim të gjitha institucionet janë përgjigjur përveç Ministrisë së Shëndetësisë, e cila as nuk ka kthyer përgjigje me shkrim dhe as nuk kanë marrë pjesë në mbledhje. Ajo ishte e mendimit që lidhur me këtë takim të njoftohet edhe Kuvendi në mënyrë që ta vertetojnë edhe ata se sa janë zbatuar këto rekomandime, sepse ato rekomandime janë miratuar nga Kuvendi. Në raport është përmbledhja e të gjeturave në dëgjim publik dhe për këtë arsye është mirë që me këtë të njoftohet edhe Kuvendi.

Pas një debati të gjerë Komisioni me pëlqimin e anëtarëve vendosi që ta njoftojë Kuvendin me përmbajtjen dhe të gjeturat e këtij raporti.

5. Shqyrtimi i realizimit të Planit të Punës për Sesionin Pranveror 2013 dhe Përgatitja e Planit për Sesionin Vjeshtor 2013

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me Planin e Punës për vitin 2013 rreth pikave të cilat nuk janë realizuar, si dhe ato që janë realizuar. Po ashtu theksoi se është e nevojshme që të përgaditet Plani i Punës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013. Ajo tha

se disa veprime duhet të kryhen duke filluar nga shtatori duke pasur parasysh se projektligjet e planifikuara nuk kanë arritur në Kuvend dhe pritet që në atë kohë të arrijnë dhe në këtë mënyrë të realizohen pikat e planit të punës, sepse për shkak që projektligjet nuk kanë arritur në Kuvend, ka rezultuar me mosrealizimin e disa pikave në Planin e Punës së Komisionit.

6. Të ndryshme.

Kryetarja – Theksoi se pas miratimit të raportit të monitorimit të Ligjit për Barazi Gjinore është bërë rishqyrtimi i rekomandimeve që kanë dalë nga ky raport dhe është konstatuar se disa rekomandime janë të tepërta të cilat nuk kanë të bëjnë me këtë monitorim dhe për këtë arsye është e nevojshme që disa nga ato të hiqen nga raporti. Ajo propozoi të hiqen rekomandimet 9, 11, 12, 14, 15 nga raporti.

Me 7 vota pro dhe një abstenim nga deputeti Kurtan Kajtazi u miratua propozimi i kryetares së Komisionit për heqjen e rekomandimeve të cekura më lart.

Rita Hajzeraj – Beqaj – I njoftoi Komisionin lidhur me një kërkesë e cila i është drejtuar Komisionit, e cila ka të bëjë me invalidët civilë të luftës të cilët kanë parashtuar disa kërkesa me qëllim të përmirësimit të gjenjdes së tyre të vështirë. Ajo ishte e mendimit se kërkesa në fjalë duhet t'i drejtohet Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sepse ata janë kompetent për shqyrtimin e kërkesave të tilla.

Albana Gashi – Ishte e mendimit se pa marrë parasysh se kërkesa është adresuar gabimisht, është mirë që Komisioni të konstatojë se a ka shkelje të të drejtave të njeriut në këtë rast? Ajo propozoi që të shqyrtohet kërkesa dhe të nxjerret një rekomandim lidhur me këtë kërkesë.

Kurtan Kajtazi – E theksoi se kërkesa është adresuar gabimisht te Komisioni, sepse në brendi të kërkesës vërehet qartë se ka të bëjë me një Komision tjetër, e jo me Komisionin për të Drejtat e Njeriut. Andaj kjo duhet të adresohet te Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me kërkesën Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione pasi e shqyrtoi kërkesën e Ilir Jasharit lidhur me invalidët civilë konstatoi se kjo nuk bie në fushëveprimin e këtij Komisioni. Andaj kërkesën për shqyrtim e delegon te Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale, pasi ky Komision është kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali